



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:039209
Datë: 20.02.2025
Numri i dokumentit: 06873728

PPP.nr.2152/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale për Mbeturina “P” sh.a, me seli në Prishtinë, rr. “T. Z” nr.5, kundër debitorit F. G, i identifikuar sipas numrit personal 10....., me adresë në Prishtinë, rr. “N. J”, lidhur me çështjen përmbartimore për borxh, në vlerë prej 451.65 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor, P.nr.664/2017, të datës 07.06.2017, të lejuar nga Përmbartuesi Privat V. B, me seli në Prishtinë, pas mbajtjes së seancës së datës 13.01.2025, me datë 28.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESËRISHT i bazuar prapësimi i debitorit F. G, nga Prishtina, ashtu që SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.664/2017, i datës 07.06.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat V. B, me seli në Prishtinë, sa i përket borxhit të kërkuar në emër të shërbimeve komunale – bartjen e mbeturinave, për periudhën nga data 01.01.2009 deri më datë 31.12.2015, në shumën prej 409.35 €, dhe lidhur me këtë shumë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.

III. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit F. G, nga Prishtina, për pjesën tjetër të propozimit lidhur me borxhin e kërkuar në emër të shërbimeve komunale – bartjen e mbeturinave, për periudhën nga data 01.01.2016 e deri më datë 25.05.2017, në shumën prej 42.30 €, dhe lidhur me këtë pjesë MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.664/2017, i datës 07.06.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat V. B, me seli në Prishtinë.

IV. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës, ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 42.30 €.

V. Në rast se debitori dështon të paguajë shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat V. B, duke vepruar sipas propozimit të kreditores ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor, P.nr. 664/2017, të datës 07.06.2017, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste, me numër identifikues nr.29494, të nxjerrë me datë 26.05.2017, lidhur me borxhin në shumë prej 451.65 €, në emër të shërbimeve të pa paguara për bartjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga data 01.01.2009 e deri më datë 25.05.2017, me kamatë 8 % nga dita e lejimit të përmbarimit e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, prapësim ka paraqitur debitori F. G. Në prapësim ka theksuar se lidhur me borxhin që i ngarkohet atij, i njëjti është parashkruar në kuptim të nenit 360 të LMD-së, tani në fuqi: *“ku përcaktohet se brenda afati prej 1 viti parashkruhen të gjitha kërkesat e kompensimit për mbeturina, pastrim, ujë, e shërbime tjera komunale”*. Mbi këto baza ka kërkuar që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor P.nr.772/18, i datës 07.06.2017 si i pabazuar dhe i palejueshëm.

Përgjigje në prapësimin e debitorit, ka paraqitur kreditori i përmbarimit, përmes të cilës ka kërkuar që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi sipas propozimit të paraqitur ndërsa kundërshtimet e debitorit të refuzohen si të pabazuara. Ka shtuar se lidhur me pretendimin e parashkrimit të kërkesës, të njëjtin e konsideron të pa bazuar, sepse debitori faktikisht dhe juridikisht ka pranuar ekzistimin e obligimit, në atë mënyrë që gjatë periudhës kontestuese i njëjti, kohë pas kohe ka paguar shumën të ndryshme nga pjesa e obligimit, duke mbetur borxh për pjesën sipas propozimit, andaj në kuptim të nenin 387 par.2 të LMD-së, nuk mund të flitet për parashkrim. Në këtë kuptim i ka propozuar Gjykatës që të mbetet në fuqi Urdhëri P.nr.664/2017, i datës 07.06.2017, i nxjerrë nga Përmbaruesi Privat V. B, ndërsa kundërshtimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, përmes Aktvendimit të datës 26.09.2017, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor për borxhin sipas kartelës nga data 01.01.2009 deri më datë 31.12.2015 dhe duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të këtij Urdhëri për borxhin sipas kartelës për periudhën kohore nga data 01.01.2016 e deri më datë 25.05.2017, në shumë prej 79.90 €.

Kundër këtij aktvendimi, ankesë ka parashtruar kreditori, ndërsa Gjykata e Apelit, përmes aktvendimit AC.nr.5640/2019, të datës 12.12.2019 e ka aprovuar si të bazuar ankesën, e ka

anuluar aktvendimin e ankimuar dhe lëndën ia ka kthyer të njëjtës gjykatë për procedim të sërishëm.

Në aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, është sugjeruar gjykata e shkallës së parë, që të hapë seancë dëgjimore, të vlerësojë në mënyrë të plotë dhe të drejtë kartelën e klientit për periudhën për të cilën kërkohet borxhi dhe pas këtij vlerësimi, të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm lidhur me prapësimin, bazuar në dispozitat e LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë, në procedim të sërishëm, konform sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së ka mbajtur seancë dëgjimore, me qëllim të vlerësimit të validitetit të prapësimit.

Debitori, në seancë dëgjimore ka deklaruar se ka qenë klient i kësaj kompanie, ka paguar rregullisht, për një moment është ndalë faturimi dhe nuk ka pranuar asnjë fature për rreth 7-8 vite, respektivisht gjatë periudhës 2009-2017. Ketë e dëshmon vetë borxhi total prej 451.00 euro pasi që siç shihet faturimi për muaj ka qene prej 4.70 euro dhe në mungesë të faturave është grumbulluar borxhi prej 451.00 euro. Ka shtuar se ka kërkuar nga një përfaqësues i kompanisë “P” arritjen e marrëveshjes për pagesën e borxhit 50 me 50 pasi që borxhi i grumbulluar është edhe si pasoje e lëshimit të kreditorit për shkak të mos dërgimit të faturave. Po ashtu, ka theksuar se qëndron pranë pretendimeve të paraqitura në prapësimin e dorëzuar me shkrim respektivisht se në rastin konkret borxhi është parashkruar. Më tej, ka theksuar se kartela e plotë e klientit e dorëzuar në seancë nga e autorizuar e kreditorit, bie në kundërshtim me provat të cilat i njëjti i posedon sepse edhe me rastin e procedimit herën e parë është interesuar pranë kompanisë “P” dhe nga e njëjta ka pranuar dëshmi se për periudhën kontestuese ka pasur fatura të lëshuara me vlerë 0.00 euro, për këtë arsye në mungesë të faturës nuk ka pasur se çfarë të paguaj. Gjykatës i ka propozuar që prapësimi të aprovohet si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhri për lejjimin e përmbarimit.

E autorizuar e kreditorit, në këtë seancë, ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë urdhrin për përmbarim, sa i përket lartësisë së borxhit dhe periudhës për të cilën është ngritur propozimi për përmbarim, ndërsa e ka kundërshtuar në tërësi pretendimin e debitorit sa i përket parashkrimit, sepse në kartelat financiare vërtetohet fakti se janë kryer pagesa me ç’rast është ndërpre parashkrimi. I ka propozuar gjykate që urdhëri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, deklarimeve të palëve në seancë dëgjimore si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, erdhi në përfundim se kemi të bëjmë me parashkrim të pjesërishtë të kërkesës së kreditorit, rrjedhimisht prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, për arsyet si në vijim:

Pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, gjykata gjeti se Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, me numër identifikues Nr.29494, i nxjerrë më datë 26.05.2017, në rastin konkret paraqet dokument të besueshëm, siç parashihet në nenin 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, se: “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë

të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm sipas këtij ligji është: [...] ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave [...]”. Ky ekstrakt po ashtu përbën bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 të LPP-së, duke i plotësuar kushtet nga paragrafi 3 i nenit 29 të po këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Me shikimin në shkresat e lëndës, shihet se dokumenti i besueshëm, përmban të dhënat e lartcekura, i njëjti është paraqitur konform nenit 37 dhe 40 paragrafi 1 pika 3 të LPP-së, andaj si i tillë i është i përshtatshëm për përmbarim konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Me dispozitat e nenit 378 par. 1 të LMD – së (i nxjerrë nga ish –RSFJ i vitit 1978), shprehimisht përcaktohet se: “Parashkruhen për një vjet: [...] kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake.” Ndërsa me nenin 361 të këtij ligji, është përcaktuar se: “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Në bazë të nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 të LMD- së, përcaktohet se: “[...] kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”, janë kërkesa të cilat parashkruhen pas një viti. Ndërsa, paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se “afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”, që do të thotë se nuk numërohet viti në të cilin është dashur të përmbushet kërkesa e arritur, por për kërkesat e tilla që janë krijuar gjatë vitit 2009, afati i parashkrimit do të fillojë nga 1 janari i vitit 2010 deri në ditën e fundit të vitit 2010, e kështu për çdo vit pasues.

Pas vlerësimit të shkresave të lëndës, respektivisht nga ekstrakti i verifikuar nga librat afarist me numër identifikues nr.29494, i nxjerrë më datë 26.05.2017 (me numër të ri identifikues 29490, i datës 25.09.2024), Gjykata gjeti se saldoja fillestare më datë 01.01.2009 ka qenë në shumën prej 153.10 €. Ndërkaq, që nga data 01.01.2009 e deri më datë 25.05.2017, pa përfshirë edhe saldon fillestare, borxhi i grumbulluar në emër të shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave, kishte arritur vlerën totale prej 451.65 €. Kjo shumë, paraqet edhe borxhin e kërkuar nga kreditori në këtë procedurë të përmbarimit. Në këtë kuptim, duke qenë se lidhur me borxhin e grumbulluar deri më datë 31.12.2015 (shih kartelen e konsumatorit), ka kaluar afati një vjeçar brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e borxhit, Gjykata vlerëson se borxhi i grumbulluar në emër të shërbimit për mbledhjen e mbeturinave për këtë periudhë, në shumën e përgjithshme prej 409.35 €, është parashkruar. Nga këto rrethana mund të konstatohet se një pjesë e borxhit nga shuma totale prej 409.35 €, dhe atë për periudhën 01.01.2009 deri më 31.12.2012, është parashkruar në pajtim me dispozitat e nenit 378 par. 1 dhe nenit 361 të LMD – së (i nxjerrë nga ish –RSFJ i vitit 1978). Ndërsa, pjesa tjetër e borxhit e faturuar nga viti 01.01.2013 deri më 31.12.2015 është parashkruar në kuptim të dispozitave të

lartcekura të Ligjit Nr. 04/ L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili është në fuqi aktualisht.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, veçanërisht në dispozitën e nenit 369 dhe 360 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”* dhe *“[...] Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”*, Gjykata gjeti se borxhi i grumbulluar në emër të shërbimeve komunale – mbledhja e mbeturinave, për periudhën 01.01.2016 deri më 25.05.2017 nuk është parashkruar.

Në referim të kësaj dispozite Gjykata erdhi në përfundim se në raport me borxhin për periudhën kohore nga data 01.01.2016, e deri me datë 25.05.2017, nuk ka ardhur në shprehje parashkrimi i kërkesës së kreditorit, për faktin se propozimi për përmbarim është paraqitur më datë 06.07.2017, që nënkupton pa kaluar afati 1 vjeçar nga arritja e secilës kërkesë për pagesë përgjatë kësaj periudhe. Rrjedhimisht, borxhin e grumbulluar për periudhën nga data 01.01.2016 e deri më datë 25.05.2017, në vlerën e përgjithshme prej 42.30 €, debitori ka për obligim që të ia paguajë kreditorit. Në llogaritjen e shumës së mbetur për pagesë, gjykata pati parasysh vetëm shumën e pa paguara përgjatë kësaj periudhe, duke zbritur nga borxhi i grumbulluar për këtë periudhë të gjitha pagesat e realizuara nga data 08.11.2016 e deri më datë 25.05.2017.

Me rastin e vendosjes, Gjykata pati parasysh edhe faktin se sipas vlerësimit të kartelës së konsumatorit, debitori, gjatë vitit 2016 ka realizuar disa pagesa dhe atë: më datë 08.11.2016 shumën prej 4.70 € dhe më datë 23.12.2016, po ashtu shumën prej 4.70 €. Pagesat e realizuara nga debitori kanë vazhduar edhe përgjatë vitit 2017, dhe atë në shumën prej nga 4.70 €, më datat 12.01.2017, 23.02.2017, 24.03.2017, 13.04.2017 dhe 25.05.2017. Megjithatë, duke qenë se pagesat e realizuara, janë realizuar në emër të faturave specifike për muajt konkret, ashtu që shumën e pagesës ka korresponduar me shumën e faturës, gjykata vlerësoi se një pagesë e tillë nuk mund të konsiderohet si pranimit i borxhit të tërësishëm, rrjedhimisht edhe nuk mund të bëhet fjalë për ndërprejen e rrjedhës së parashkrimit të kërkesës për këtë periudhë.

Gjykata, shqyrtoi edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse dhe vlerësoi se të njëjtat nuk janë objekt i shqyrtimit në procedurën përmbarimore andaj edhe i konsideroi si jo relevante për vendosje meritorie në këtë çështje juridike përmbarimore. Gjykata vë në dukje faktin se procedura përmbarimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, që nënkupton se objekt vlerësimi është vetëm përshtatshmëria e dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, në kuptim të vlerësimit të përmbushjes së tipareve të cilat kërkohen me ligj për tu trajtuar si i tillë. Andaj, pretendimet e debitorit se i njëjti në procedurën paraprake ka pranuar fatura në vlerë 0.00 euro, rrjedhimisht nuk ka mundur të realizojë pagesën e borxhit sipas këtyre faturave, gjykata e vlerësoi si pretendim, të pa mbështetur në prova e mbi të gjitha jo relevant për këtë procedurë, përderisa borxhi i grumbulluar përgjatë periudhës së kërkuar me propozim, evidentohet në kartelën e konsumatorit të regjistruar në emrin e debitorit.

Në kuptim të kësaj, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhërin për lejimin e përmbarimit, lidhur me borxhin real të debitorit, të krijuar për periudhën 01.01.2016 e deri më datë 31.12.2017 dhe atë në vlerë 42.30 €. Ndërkaq, lidhur me pjesën tjetër të detyrimit të kërkuar nga kreditori, që e tejkalon shumën për të cilën urdhëri përmbarimor është lënë në fuqi, u vendos si në pikën I të dispozitivit, duke u shfuqizuar urdhëri për lejimin e përmbarimit dhe duke u përfunduar procedura lidhur me atë pjesë.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale, Gjykata e mori konform dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, e lidhur me nenin 449 dhe 452 paragrafi 2 të LPK-së. Me dispozitën e nenit 463 paragrafi 1 të LPK-së është përcaktuar se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale, gjykata vendos vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*, ndërsa me paragrafin 2 të kësaj dispozite, përcaktohet se: *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar, t’i tregojë shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*. Tutje, neni 449 i LPK-së, përcakton përbërjen e shpenzimeve procedurale, ndërkaq neni 452 paragrafi 2 i LPK-së, përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta [...]”* Në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e ngarkuar secilën palë me shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata, në kuptim të nenit 73 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.2152/2019, më datë 28.01.2025

G j y q t a r j a
Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për Gjykatën dhe palët.